REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e martë, datë 17.11.2026, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Armela	**KRASNIQI**	**Kryetar**
Desada	**METAJ**	**Zëvendëskryetar**
Aurela	**BICJA**	**Anëtar**
Besian	**ZOGAJ**	**Anëtar**
Gjergji	**HAMITI**	**Anëtar**
Jetmir	**HALILAJ**	**Anëtar**
Joana	**ALLUSHI**	**Anëtar**

AMA, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Rinovimin e autorizimit të subjektit person fizik "Ylli Xhafa", për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor "Ylli Net+Tv Kabllor", për një periudhë 5 (pesë) vjeçare. **(Vendim nr. 127, datë 17.11.2026)**
2. Konstatimin e pavlefshmërisë së autorizimit të subjektit person fizik Gentian Biqiku, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve, mbështetur në rrjet kabllor "TV Kabllor M&G". **(Vendim nr. 128, datë 17.11.2026)**
3. Pranimin e kërkesës të shoqërisë "Albanian Satellite Communications" sh.p.k., për bashkimin me përthithje të shoqërisë "TV Kabllor Shijaku" sh.p.k, duke kaluar të drejtat dhe detyrimet e autorizimit lëshuar për shoqërinë "TV Kabllor Shijaku" sh.p.k., për për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve, mbështetur në rrjet kabllor "TV Kabllor Shijaku", me afat vlefshmërie të autorizimit deri më 28.07.2028.
   - T'i heqë shoqërisë "TV Kabllor Shijaku" sh.p.k., autorizimin për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve, mbështetur në rrjet kabllor "TV Kabllor Shijaku" **(Vendim nr. 129, datë 17.11.2026)**
4. Rinovimin e autorizimit, të shoqërisë "Opticom" sh.p.k, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor "TV Kabllor Kuçova", për një periudhë 5 (pesë) vjeçare. **(Vendim nr. 130, datë 17.11.2026)**
5. Miratimin e propozimit për një ndryshim në buxhetin e vitit 2026. **(Vendim nr. 131, datë 17.11.2026)**

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 17 nëntor 2026